

VENDIM
Nr.110, datë 7.7.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR HETIMIN E FAKTEVE, RRETHANAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË MASAKRËS SË TIVARIT, 1945”, TË NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.45, DATË 15.7.2010

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësive të masakrës së Tivarit, 1945”, të ngritur me vendimin e Kuvendit nr.45, datë 15.7.2010, zgjatet për një periudhë 6-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)